

URDHËR
Nr. 365, datë 10.8.2022

**PËR IMPORTIN E KAFSHËVE TË LLOJIT DERRA, PRODUKTEVE,
NËNPRODUKTEVE TË TYRE, MATERIALIT BIOLOGJIK, EMBRIONEVE, MISHIT
DHE NËNPRODUKTEVE TË TYRE NGA HUNGARIA, LETONIA, UKRAINA,
RUMANIA, ITALIA, GJERMANIA, LITUANIA, MOLDAVIA, SLLOVAKIA, SERBIA,
ESTONIA, BULLGARIA, POLONIA DHE MAQEDONIA E VERIUT**
(ndryshuar me urdhrin nr. 431, datë 27.9.2022)

(i përditësuar)

Mbështetur në nenin 102, pika 4, e Kushtetutës, neni 43, i ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, e të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, produkteve të tyre, materialit biologjik dhe embrioneve e kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 1.1 deri në pikën 1.8, përkatësisht nga:

Shteti i Hungarisë: qarku Borsod-Abaúj-Zemplén, qyteti Gönc; qarku Hajdú-Bihar, qyteti Debrecen dhe Hajdúböszörmény; qarku Jász-Nagykun-Szolnok, qyteti Tiszafüred; qarku Nógrád, qyteti Bátonyterenye; qarku Szabolcs-Szatmár-Bereg, qyteti Nyíregyháza, *qarku Pest, qyteti Pilisvörösvár;*

Shteti i Letonisë: rajoni Latgales qyteti Augšdaugavas, njësi administrative Dēmenes; qyteti Balvu, njësi administrative Susāju; qyteti Dienvidkurzemes, njësi administrative, Rucavas; qyteti Kuldīga, njësi administrative Īvandes, Kurmāles dhe Laidu; qyteti Ludzas, njësi administrative Cirmas; qyteti Zemītes dhe Tumes; qyteti Ventspils, njësi administrative Jūrkālnes, Piltēnes, Popes; rajoni Vidzemes, qyteti Madona, njësi administrative Barkavas dhe Skultes; rajoni Vīzemes, qyteti Madonas, njësi administrative Indrānu, qyteti Valmieras, njësi administrative Valmieras, Naukšēnu dhe Plāņu, qyteti Cēsu; qyteti Valkas, njësi administrative Ērgemes; rajoni Zemgales, qyteti Aizkraukles, njësi administrative Skrīveru; njësi administrative Zaļenieku, Līvānbeles, *rajoni Latgales, qyteti Krāslavas, njësi administrative Šķaunes; rajoni Kurzemes, qyteti Kuldīga, njësi administrative Ēdoles; qyteti Madonas, njësi administrative Prāuliēnas; rajoni Kurzemes, qyteti Tukuma, njësi administrative Slampes; rajoni Zemgales, qyteti Dobele, njësi administrative Annenieku; rajoni Latgales, qyteti Rēzeknes, njësi administrative Gaigalavas; rajoni Latgales, qyteti Preiļi, njësi administrative Rušonas; rajoni Kurzemes, qyteti Tukuma, njësi administrative Degoles, njësi administrative Vārkavas; rajoni Kurzemes, qyteti Dienvidkurzemes, njësi administrative Sakas; rajoni Vidzemes, qyteti Cēsu, njësi administrative Raiskuma; rajoni Kurzemes, qyteti Ventspils, njësi administrative Vārves; rajoni Latgales, qyteti Ludzas, njësi administrative Nukšu; rajoni Latgales, qyteti Balvu, njësi administrative Lazdulejas; rajoni Vidzemes, qyteti Madonas, njësi administrative Ošupes; rajoni Kurzemes, qyteti Talsu, njësi administrative Līvāgu; rajoni Kurzemes, qyteti Kuldīga, njësi administrative Skrundas; rajoni Vidzemes, qyteti Madonas, njësi administrative Aronas; rajoni Vidzemes, qyteti Gulbene, njësi administrative Daugpils; rajoni Vidzemes, qyteti Alūksnes, njësi administrative Līvānas; rajoni Vidzemes, qyteti Gulbene, njësi administrative Stāmerienas; rajoni Latgales, qyteti Balvu, njësi administrative Kubulu; rajoni Vidzemes, qyteti Madonas, njësi administrative Ošupes; rajoni Vidzemes, qyteti Smiltēnes, njësi administrative Grundzāles; rajoni Latgales, qyteti Rēzeknes, njësi administrative Silmalas; rajoni Latgales, qyteti*

Rēzeknes, njësia administrative Ilzeskalna; rajoni Latgales, qyteti Preiļu, njësia administrative Rušonas; rajoni Latgales, qyteti Rēzeknes, njësia administrative Gaigalavas.

Shteti i Ukrainës, përkatësisht: rajoni Konotops'kyi, qyteti Sumy, Făleşti, Străşeni, Cahul, Edineţ, Sîngerei; i gjithë territori i shtetit të **Rumanisë.**

Shteti i Italisë: rajoni i Lazio, qyteti i Romës, Rieti; rajoni Piemonte, qyteti Alessandria; rajoni Liguria, qyteti Genova; rajoni Sardegna, qyteti Nuoro.

Shteti i Gjermanisë: rajoni i Baden-Württemberg, qyteti Emmendingen, njësia administrative Nördlicher Kaiserstuhl; rajoni Brandenburg, qyteti Barnim, njësia Britz-Chorin-Oderberg; qyteti Frankfurt (Oder), njësia administrative Frankfurt (Oder); qyteti Märkisch-Oderland, njësia administrative Lebus, Bad Freienwalde (Oder), Golzow; qyteti Oberspreewald-Lausitz, njësia administrative Großräschen dhe Ruhland; qyteti Oder-Spree, njësia administrative Odervorland, Scharmützelsee dhe Rietz-Neuendorf; qyteti Spree-Neiße, njësia administrative Schenkendöbern, Döbern-Land, Spremberg, Guben, Forst (Lausitz) dhe Döbern-Land; qyteti Uckermark, njësia administrative Schwedt/Oder, Gartz (Oder), Oder-Welse dhe Angermünde; rajoni Mecklenburg-Vorpommern, qyteti Ludwigslust-Parchim, njësia administrative Parchimer Umland, Eldenburg Lübz, Grabow; rajoni Sachsen, qyteti Bautzen, njësia administrative Malschwitz, Schwepnitz, Königsbrück, Pulsnitz, Großdubrau, Spreetal, Lohsa, Wachau; qyteti Görlitz, njësia administrative Weißwasser/O.L., Diehsa, Markersdorf, Boxberg/O.L., Schleife, Niesky, Markersdorf, Bernstadt/Schönau-Berzdorf, Diehsa, Schleife, Reichenbach/O.L., Ostritz, Weißer Schöps/Neiße; qyteti Meißen, njësia administrative Thiendorf, Ebersbach, Moritzburg, Schönfeld, Radeburg, Thiendorf, Schönfeld; qyteti Nordsachsen, njësia administrative Wermsdorf; qyteti Sächsische Schweiz-Osterzgebirge, njësia administrative Lohmen/Stadt Wehlen *rajoni Niedersachsen, qyteti Cloppenburg, njësia administrative Garrel; rajoni Niedersachse, qyteti Emsland, njësia administrative Twist; rajoni Schleswig-Holstein, qyteti Nordfriesland, njësia administrative Südtondern; rajoni Brandenburg, qyteti Spree-Neiße, njësia administrative Peitz.*

Shteti i Lituanisë: qyteti Kauno, Bashkia Kėdainių, Kauno, Kaišiadorių, Prienų, Jonavos; qyteti Klaipėdos, bashkia Kretingos dhe Skuodo; qyteti Marijampoles, Bashkia Šakių; qyteti Šiauliai, Bashkia Akmenės dhe Šiaulių; qyteti Taurages, Bashkia Tauragės dhe Jurbarko; qyteti Telšiai, Bashkia Telšių; qyteti Utenos, Bashkia Anykščių, Molėtų, Zarasų, Utenos, Ignalinos dhe Zarasų; qyteti Vilniaus, Bashkia Švenčionių, Trakų, Vilniaus.

Shteti i Moldavisë: qyteti i Edineţ, Dubăsari, Briceni, Rîşcani, Sîngerei, Făleşti, Străşeni, Cahul dhe Edineţ.

Shteti i Sllovakisë: rajoni Banskobystrický, qyteti Brezno, Banská Bystrica, Poltár, Rimavská Sobota, Zvolen, Lucenec, Krupina, Velký Krtíš, Detva, Revúca, Žiar nad Hronom, Revúca; rajoni Košický, qyteti Rožnava, Sobrance, Trebišov, Michalovce, Spišská Nová Ves, Košice-okolie; rajoni Prešovský, qyteti Bardejov Humenné, Levoca

Prešov, Vranov nad Topľou, Stropkov, Kežmarok, Sabinov, Kežmarok, Medzilaborce, Svidník, Snina dhe Poprad; rajoni Žilinský, qyteti Liptovský Mikuláš.

Shteti i Serbisë: rajoni Borski, Bashkia Majdanpek dhe Kladovo; rajoni Braničevski, Bashkia Kučevo, Golubac dhe Veliko Gradište; rajoni Nišavski, Bashkia Ražanj dhe Niš; rajoni Pirotski, Bashkia Pirot, Dimitrovgrad dhe Babušnica; rajoni Zaječarski, Bashkia Sokobanja dhe Boljevac, *rajonet Južnobanatski, Niiavski, Pomoravski, Pčinjski, Jablanički dhe Podunavski.*

Shteti i Estonisë: qarku Harju, Bashkia Harju, fshati Tagadi; Bashkia Kose, fshati Tammiku; rajoni Ida-Viru, Bashkia Toila, fshati Voka; Bashkia Kohtla-Nõmme, fshati Kohtla-Nõmme; rajoni Järva, Bashkia Roosna-Alliku, fshati Oeti; qarku Jõgeva, fshati Torma, fshati Liikatu; rajoni Lääne-Viru, Bashkia Viru-Nigula, fshati Viru-Nigula, Pada, Malla, Mahu; Bashkia Laekvere, fshati Luusika; Bashkia Rägavere, fshati Viru-Kabala; Bashkia Väike-Maarja, fshati Pikevere; Bashkia Vihula, fshati

Lauli; rajoni Pärnu, Bashkia Tõstamaa, fshati Päraküla; rajoni Põlva, Bashkia Mikitamäe, fshati Laossina; Bashkia Orava, fshati Kõvera, Kamnitsa; Bashkia Räpina, fshati Linte; rajoni Rapla, Bashkia Kohila, fshati Urge; rajoni Saare, Bashkia Kärla, fshati Hirmuste; rajoni Viljandi, Bashkia Abja, fshati Penuja; Bashkia Tarvastu, fshati Soe.

Shteti i Bullgarisë: rajoni Blagoevgrad, Burgas, Dobrich, Gabrovo, Haskovo, Kardzhali, Kyustendil, Pazardzhik, Pernik, Plovdiv, Razgrad, Ruse, Shumen, Sliven, Smolyan, Sofia, Stara Zagora, Tragovishte, Varna, Veliko Tarnovo dhe Yambol.

Shteti i Polonisë: rajoni Dolnośląskie, Lubelskie, Lubuskie, Małopolskie, Mazowieckie, Opolskie, Podkarpackie, Podlaskie, Pomorskie, Warmińsko-Mazurskie, Wielkopolskie dhe Zachodniopomorskie.

Shteti i Maqedonisë së Veriut: njësia administratie Delcevo, fshati Kostin Dol; bashkia Makedonska Kamenica, fshati Moshtica, *qyteti Koçani, qyteti Vinitsa*.

1.1. Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që kafshët:**

- a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave ditën e dërgesës;
- b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të murtajës afrikane të derrave; ose
- c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

1.2 Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që kafshët donatore të materialit biologjik:**

- a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur, në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vjetët e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;
- b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;
- c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Terrestrial të OIE-së;
- ç) sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11 të Kodit Terrestrial të OIE-së, sipas rastit.

1.3 Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që kafshët donatore të embrioneve:**

- a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vjetët e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;
- b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;
- c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;
- ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitullit 4.8 dhe 4.10 të Kodit Terrestrial të OIE-së.

1.4 Për mishin e kafshëve të llojit derra të butë ose të egër, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet, që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra, që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërtetohet se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tre vjetëve të fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

1.5 Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet, që:**

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga murtaja afrikane e derrave në përputhje me pikën 1 ose pikën 2 të nenit 15.1.4 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) u janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së në një objekt ekzaminimi të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti.

1.6 Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet, që:**

a) mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15. dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së, ose;

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

1.7 Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet, që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

1.8 Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet, që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zone të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2 të nenit 15.1.4 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartament pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim virusit të murtajës afrikane të derrave.

2. Urdhri nr. 14, datë 14.1.2022, “Për importin e kafshëve të llojit derra, produkteve, nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre nga Republika e Maqedonisë së Veriut”, dhe urdhri nr. 335, datë 13.7.2022, “Për importin e kafshëve të llojit derra, produkteve, nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre nga Hungaria, Letonia, Ukraina, Rumania, Italia, Gjermania, Lituania, Moldavia, Sllovakia, Serbia, Estonia, Bullgaria dhe Polonia”, shfuqizohet.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Politikave dhe Programeve të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet, Drejtoria e Politikave Veterinare në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Dhimitër Kote